Vendim nr. 301, datë 28.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 28.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (V) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **VIKTOR (XHEVAHIR) ELEZI**, përfaqësuar nga avokati Baftjar Rusi, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 53, datë 21.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 1771/30-2023-6353, datë 07.11.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2026-145, datë 10.02.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, me tjetër trup gjykues.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, pika 1, 17, 18, 27, 28, 30, 31, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 5, 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 49, 50, 51, 72 dhe 73 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 22.09.2017, një shtetas është dërguar në Urgjencën e Spitalit Rajonal Peshkopi nga dy persona të paidentifikuar, pasi ishte qëlluar me armë zjarri në pjesën e gjoksit. Më vonë, atë ditë, kërkuesi është paraqitur në Komisariatin e Policisë së Dibrës, duke marrë përgjegjësi për ngjarjen. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (*Prokuroria e Dibrës*) në datën 22.09.2017 ka regjistruar procedimin penal nr. 441 (*procedimi penal nr. 441/2017*) në ngarkim të kërkuesit, i dyshuar për veprat penale "Vrasja me dashje" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 76 dhe 278, pika 1, të Kodit Penal *(KP)*, si dhe në ngarkim të shtetasit V.T., i dyshuar për veprën penale "Përkrahja e autorit të krimit", të parashikuar nga neni 302 i KP-së.

2. Kërkuesi ka pretenduar se ngjarja kishte ndodhur aksidentalisht dhe se me viktimën kishte qenë shumë shok. Ai ka deklaruar se viktima e kishte telefonuar për ta ftuar në një lokal dhe se e ka gjetur atë në shoqërinë e personi tjetër (i bashkëpandehuri), të cilin nuk e njihte, se ndërkohë që po bisedonin, viktima kishte nxjerrë nga brezi një pistoletë për t'ia treguar dhe se në momentin qe e kishte marrë pistoletën në dorë, ishte shkrepur pa dashje. Më pas ata e kanë hipur viktimën në makinën e personit tjetër dhe janë nisur për në spital, ndërsa kërkuesi kishte shkuar nga pas me makinën e tij. Pas identifikimit është pyetur edhe shtetasi V.T., i cili ka sqaruar se pas ftesës së shtetasit R.S. ishte ulur në një tavolinë me të dhe me viktimën, dhe se ky i fundit kishte marrë në telefon një person tjetër (kërkuesin) për ta ftuar. Referuar deklaratës, ndërkohë që dy personat e tjerë bisedonin, ai ka qenë duke luajtur në telefon dhe në një moment ka dëgjuar një zhurmë të fortë dhe ka vënë re se personi tjetër ka filluar të bërtasë "Çfarë bëra". Më pas të dy bashkë e kanë çuar viktimën në spital me makinën e tij. Në lidhje me armën, ai ka deklaruar se kërkuesi e kishte nxjerrë në një moment nga çanta, pastaj e kishte futur përsëri brenda. Gjatë hetimeve paraprake janë pyetur: i) shtetasi R.S., i cili ka deklaruar fillimisht se kishte qëndruar me viktimën deri rreth orës 21:45 dhe pastaj ishin nisur për në shtëpi. Në një deklarim të dytë ai ka pohuar se kishin qëndruar te lokali i tij deri rreth orës 00:30, kur ai ishte larguar për në shtëpi me automjetin e viktimës, të cilin e kishte lënë në lokal së bashku me V.T. Për mospërputhjen midis deklarimeve, ky shtetas ka mbajtur qëndrimin se fillimisht ka qenë i tronditur, duke iu përmbajtur deklarimit të

dytë; ii) shtetasi N.D., roja e karburantit, i cili ka deklaruar se nuk kishte parë gjë pasi kishte qenë në gjumë; iii) shtetasi L.N., i cili ka deklaruar se nuk ka qenë ai që ka hapur lokalin, por polici i zonës, i cili ka kontrolluar ambientin. Në cilësinë e dëshmitarëve janë pyetur edhe punonjësit e spitalit, shtetasit B.S. dhe A.H., të cilët kanë pasur kontaktin e parë me viktimën, duke pohuar se viktima ishte sjellë në spital nga dy persona, që nuk kanë mundur t'i identifikonin.

3. Gjithashtu, gjatë hetimeve paraprake: i) është këqyrur vendi i ngjarjes dhe mjeti me të cilin është bërë transportimi i viktimës për në spital; ii) është këqyrur kufoma e viktimës në prani të mjekut ligjor, nga është konstatuar një vrimë hyrjeje plumbi mbi stomak; iii) është këqyrur aparatit celular i viktimës nga ku është konstatuar se nga ora 01:34 deri rreth orës 01:57 ka pasur komunikime të vazhdueshme me kërkuesin; iv) janë këqyrur pamjet filmike të kamerave të sigurisë të lokalit ku ka ndodhur ngjarja, nga të cilat është konstatuar se në orën 01:48 ka ardhur me makinë kërkuesi, i cili pasi ka parkuar makinën, është futur në lokal duke mbajtur në dorë një çantë, pak minuta më vonë ka shkuar sërish në makinë dhe pas një minute ka shkuar përsëri në lokal, duke varur krahëqafë një çantë. Në orën 02:11 nga lokali kanë zbritur viktima dhe V.T që po nxitonin, njëri mezi lëvizte, të cilët hipin në makinë dhe largohen. Në orën 02:12, nga lokali ka dalë duke vrapuar kërkuesi dhe ka shkuar te makina e tij, ka hipur dhe është larguar. Në orën 02:35 ka ardhur përsëri në lokal me makinë shtetasi V.T., duke qëndruar pak minuta brenda në lokal, e më pas është larguar; v) janë këqyrur pamjet filmike të kamerave të sigurisë të një subjekti tregtar që ndodhet në rrugën që të çon për te spitali, nga ku është konstatuar se në drejtim të spitalit kishte lëvizur një automjet tip "Mercedes Benz" dhe po i njëjti automjet është larguar nga spitali pak minuta më vonë; vi) është kryer akti i ekspertimit tekniko-balistik nr. 11011, datë 10.10.2017, ku është konkluduar se drejtimi i qitjes është nga poshtë lart, nga e majta në të djathtë; vii) në aktin e ekspertimit kimik të faktorëve të plotësues të qitjes nr. 10799, datë 05.10.2017, është konkluduar se në pjesën e karriges objekt ekspertimi nuk është evidentuar prania e nitriteve dhe nitrateve, të cilat janë të pranishme dhe te mbeturinat e faktorëve plotësues të qitjes me armë zjarri; viii) janë kryer aktet e ekspertimeve kimike nr. 10799, datë 05.10.2017, nr. 11213, datë 17.10.2017, nr. 10803, datë 05.10.2017 dhe nr. 10803, datë 05.10.2017, nga ku ka rezultuar se te kufoma, kërkuesi, shtetasi V.T. dhe shtetasi R.S. nuk u evidentua prania e nitriteve dhe nitrateve të cilat janë të pranishme dhe te mbeturinat e faktorëve plotësues të qitjes me armë zjarri.

4. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Dibrës ka depozituar në gjykatë kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale me të pandehur kërkuesin, i akuzuar për veprat penale "Vrasja nga pakujdesia" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe i municionit", të

parashikuara nga nenet 85 dhe 278, pika 1, të KP-së, si dhe shtetasin V.T., të dyshuar për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të parashikuar nga neni 301 i KP-së.

5. Gjatë zhvillimit të seancës paraprake, kërkuesi ka kërkuar gjykimin me ritin e gjykimit të shkurtuar, e cila nuk është shqyrtuar, pasi gjykata i ka kërkuar prokurorit të çështjes ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në ngarkim të kërkuesit nga "Vrasja nga pakujdesia" në "Vrasja me dashje". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 105 (33-2018-307), datë 04.04.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Dibrës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kthimin asaj të akteve që i përkasin procedimit penal në fjalë, pasi ka vlerësuar se cilësimi juridik që prokuroria i kishte bërë akuzës ishte e gabuar dhe kjo e fundit nuk i kishte bërë ndryshimet përkatëse. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe Prokuroria e Dibrës.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1494, datë 30.05.2018, ka vendosur mospranimin e ankimeve ndaj vendimit të mësipërm, duke arsyetuar se sipas ligjit procedural ky vendim i gjyqtarit të seancës paraprake është i paankimueshëm, pasi ligji procedural penal nuk ka parashikuar që çdo vendim që merret gjatë fazës së hetimit nga gjyqtari i hetimeve paraprake është i ankimueshëm në gjykatat më të larta. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesi dhe Prokuroria e Dibrës.

7. Në zbatim të vendimmarrjes së mësipërme, Prokuroria e Dibrës i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të kërkuesit, i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 76 dhe 278/1 të KP-së, si dhe në ngarkim të shtetasit V.T., të akuzuar për "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të parashikuar nga neni 301 i KP-së. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me vendimin nr. (33-2018-768) 203, datë 20.09.2018.

8. Me vendimin nr. 53, datë 21.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër kërkuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale "Vrasja nga pakujdesia", të parashikuar nga neni 85 i KP-së, dhe "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe municionit", të parashikuara nga neni 278/1 i KP-së, duke e dënuar atë me një dënim të vetëm prej 7 vjetësh burgim. Gjatë shqyrtimit gjyqësor me procedurën e gjykimit të zakonshëm në gjykatën e rrethit gjyqësor janë realizuar leximet e lejuara të deklarimeve të pronarit të lokalit ku ka ndodhur ngjarja dhe vëllait të viktimës, ndërsa janë pyetur me cilësinë e dëshmitarit personeli mjekësor që ka pritur në urgjencë viktimën, lavazhieri pranë lokalit ku kishte ndodhur ngjarja, roja te karburanti pranë lokalit, bashkëshortja e viktimës, e cila ka deklaruar se nuk kishte dijeni nëse i shoqi ka pasur

ndonjë konflikt të mëparshëm me kërkuesin, pasi nuk e kishte dëgjuar kurrë këtë emër. Janë këqyrur pamjet filmike të kamerave të sigurisë të një subjekti në rrugën e spitalit, si dhe janë administruar në cilësinë e provës të gjitha aktet e ekspertimit të realizuara gjatë hetimeve paraprake. Në analizë të këtyre provave ajo gjykatë ka çmuar se nuk provohej elementi objektiv i veprës së vrasjes me dashje, pasi nuk rezultoi të kishte konflikt, zënkë, rrahje ose grindje me karakter serioz midis autorit dhe viktimës. Sipas saj, rezulton e provuar nga deklarimet e personit të pranishëm në ngjarje, V.T. dhe dëshmitarë të tjerë, se kërkuesi dhe viktima nuk kanë pasur konflikte midis tyre, por përkundrazi se kanë pasur marrëdhënie shoqërore dhe se natën e ngjarjes viktima e ka prezantuar si shokun e tij. Nga ana subjektive, sipas gjykatës, nuk provohet që kërkuesi ta ketë kryer veprën penale me dashje, pasi nuk ka synuar vdekjen e tij. Si tregues të këtij elementi, ajo gjykatë ka çmuar reagimin e menjëhershëm të kërkuesit pas shkrepjes së armës, thirrjen "Çfarë bëra?" dhe përpjekjet e tij, së bashku me V.T., për ta dërguar viktimën në spital. Në kushtet kur kërkuesi e ka kryer veprën me armë zjarri, të cilën e mbante pa leje të organeve kompetente, është deklaruar fajtor edhe për veprën e parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së. Për sa i përket të pandehurit tjetër, V.T., ai është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale "Veprimeve që pengojnë zbulimin e të vërtetës", të parashikuar nga neni 301 i KP-së. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim të pandehurit dhe prokuroria.

9. Ndërkohë, në lidhje me rekurset e paraqitura kundër vendimit të gjykatës së apelit për kthimin e akteve prokurorit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-20, datë 25.01.2022, ka vendosur mospranimin e tyre, me arsyetimin se ato nuk kanë më objekt, pasi kërkuesi është dënuar fajtor me vendimin nr. 53, datë 21.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Gjithashtu, sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e themelit ka zgjidhur çështjen e cilësimit juridik të akuzës nga prokuroria, duke e ndryshuar atë sërish në veprën penale "Vrasja nga pakujdesia", të parashikuar nga neni 85 i KP-së.

10. Në datën 24.03.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve për kthimin e akteve prokurorit si jokushtetuese. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 53, datë 11.05.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se çështja penale në ngarkim të kërkuesit në lidhje me themelin e akuzës është duke u gjykuar në gjykatat e zakonshme.

11. Në lidhje me themelin e akuzës, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1771/30-2023-6353, datë 07.11.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 53, datë 21.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke e ndryshuar për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale kryesore në ngarkim të kërkuesit, nga "Vrasje nga pakujdesia" në "Vrasja

me dashje", të parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar atë me 16 vjet burgim. Në vlerësim të anës subjektive të figurës së veprës penale, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi ka pasur si qëllim dëmtimin serioz të shëndetit të viktimës, pasi ishte paraqitur në takim i armatosur me një pistoletë të siguruar më parë, të cilën e mbante pa leje, ndërsa nuk provohej ndonjë arsye e ligjshme që ai ta mbante armën të drejtuar te pjesët jetike të trupit të viktimës. Ajo gjykatë ka vlerësuar se pretendimi për marrëdhënie të mira me viktimën nuk mbështetej në prova, pasi familjarët e viktimës nuk e kanë identifikuar kërkuesin si pjesë e rrethit të tij shoqëror. Mbi këtë bazë, ajo gjykatë ka konkluduar se kërkuesi kishte vepruar me dashje indirekte, duke arsyetuar se mundësia për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij ishte shumë e lartë. Në ndryshim nga pakujdesia, ku pasoja shihet thjesht si e mundshme, gjykata e apelit vlerësoi se në rastin konkret pasoja ishte pothuajse e sigurt dhe e parashikueshme. Sipas saj, fakti që kërkuesi ka marrë armën dhe është paraqitur në takim i armatosur, ka krijuar kushtet për realizimin e ngjarjes, ndërsa lejimi i ardhjes së pasojës tregonte vendosmërinë e tij për arritjen e rezultatit kriminal, pra vrasjen e viktimës.

12. Më tej, gjykata e apelit ka konstatuar mangësi të theksuara të hetimit deri në nivel të veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Nga pamjet filmike të këqyrura nga trupi gjykues ka rezultuar se punonjësit e policisë kanë shkuar në vendngjarje në datën 22.09.2017, rreth orës 3:00, por ky veprim nuk është pasqyruar në asnjë akt procedural, ndërkohë që procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes është hartuar më 23.09.2017, ora 11:00. Ajo gjykatë ka vlerësuar se mosruajtja e menjëhershme e vendngjarjes dhe moskryerja e veprimeve hetimore për të verifikuar nëse qitja në një ambient publik kishte vënë në rrezik persona të tjerë, përbënin mospërmbushje e rregullt e detyrës, për rrjedhojë, ka arsyetuar se i gjithë niveli drejtues dhe zbatues që ka ushtruar funksionin e oficerit të policisë, duhej të procedoheshin penalisht për veprime ose mosveprime në kundërshtim me detyrën dhe ligjin funksional për Policinë e Shtetit.

13. Shkakun e ankimit që çështja duhej të prishej dhe të kthehej për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, pasi çështja penale është gjykuar mbi bazën e akteve fotokopje, gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk qëndron dhe se nuk ka bazë ligjore, duke sqaruar se në rastet e veçimit të dosjeve, shqyrtimet e çështjeve penale vijojnë po në të njëjtin mënyrë mbi bazën e fotokopjes së njësuar të akteve, krahas faktit se pas shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, ato janë bërë pjesë e këtij fashikulli që do të thotë kanë qenë origjinale.

14. Edhe në lidhje me pretendimin e kërkuesit për përfitimin e gjykimit të shkurtuar, gjykata e apelit ka çmuar se nuk qëndron, duke arsyetuar se nga përmbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 20.12.2018 rezulton se kërkuesi nuk ka kërkuar gjykim të shkurtuar për

veprën penale të vrasjes me dashje, por ka kërkuar që gjykimi të vijonte me procedurë të zakonshme të gjykimit, duke i qëndruar akuzës së vrasjes nga pakujdesia. Gjithashtu, me vendimin e ndërmjetëm të datës 20.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër është vendosur mospranimi i kërkesës për gjykimin e shkurtuar për të pandehurin V.T., pasi nga ajo gjykatë është vlerësuar se nuk kanë qenë kushtet për ndarjen e procedimeve të çështjes për të dy të pandehurit, sepse veprat penale ishin të lidhura. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

15. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-145, datë 10.02.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka konstatuar se ai është depozituar jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 435 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) dhe se kjo rrethanë përbën pengesë formale për marrjen e tij në shqyrtim. Megjithatë, ajo gjykatë ka çmuar se është e nevojshme të shprehet shkurtimisht edhe mbi thelbin e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat i ka gjetur haptazi të pabazuara.

16. Konkretisht, Kolegji Penal ka konstatuar se kërkuesi ngre tre pretendime kryesore. Lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar, ai kolegj ka arsyetuar se kërkuesi e kishte paraqitur këtë kërkesë në seancën paraprake të parë, gjatë së cilës është shqyrtuar kërkesa e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia. Megjithatë, pas vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor për kthimin e akteve prokurorit, prokuroria ka ngritur një akuzë të re për vrasje me dashje dhe ka kërkuar sërish dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas Kolegjit Penal, në seancën paraprake të zhvilluar për shqyrtimin e kësaj akuze të re, kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar. Duke iu referuar nenit 403, pika 1 të KPP-së, i cili kërkon që kjo kërkesë të paraqitet në seancën paraprake, Kolegji Penal ka vlerësuar se mosushtrimi i saj në këtë fazë ka shkaktuar humbjen e së drejtës procedurale për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar.

17. Për sa i përket pretendimit se vendimi i gjykatës së apelit bie në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë dhe të kësaj Gjykate, ai kolegj ka arsyetuar se vendimet e referuara nga kërkuesi kishin të bënin vetëm me ankimin ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake për kthimin e akteve prokurorit. Në këtë drejtim, ka evidentuar se as Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, dhe as kolegji i kësaj Gjykate, që ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, nuk kishin dhënë asnjë orientim lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, ose interpretimin e neneve 76 dhe 85 të KP-së. Për rrjedhojë, Kolegji Penal ka vlerësuar se këto vendime nuk kishin krijuar praktikë gjyqësore të detyrueshme për çështjen në shqyrtim dhe se vendimmarrja e gjykatës së apelit nuk binte në kundërshtim me to.

18. Në lidhje me pretendimin për rikualifikimin e veprës penale, me argumentin se ky ndryshim është bërë në keqzbatim të ligjit penal material dhe në kundërshtim me provat e

administruara, ai kolegj ka vërejtur se thelbi i pretendimit përbën një kërkesë për rivlerësimin e fakteve dhe të provave, gjë që del jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Për më tepër, Kolegji Penal ka çmuar se gjykata e apelit ka kryer një analizë të detajuar të provave të administruara, duke ekzaminuar pamjet filmike të kamerave të sigurisë, deklarimet e dëshmitarëve, aktet e ekspertimit mjeko-ligjor dhe balistik, si dhe rrethanat objektive të ngjarjes dhe, mbi bazën e kësaj analize, ka arritur në përfundimin se kërkuesi ka vepruar në formën e dashjes indirekte. Kërkuesi, sipas tij, nuk ngre ndonjë çështje të interpretimit të normës juridike me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, por përqendrohet në rivlerësimin e rrethanave faktike, të cilat i përkasin çmuarjes së provave nga gjykatat e faktit.

19. Në datën 04.06.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

20. ***Kërkuesi****,* në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor,* në drejtim të:

20.1. *Së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykata e apelit nuk ka arsyetuar mjaftueshëm për: i) arsyet për të cilat vendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte i gabuar, duke ndërtuar një arsyetim paralel mbi të njëjtat prova, pa u përballur qartë dhe drejtpërdrejt me analizën e saj; ii) argumentet e mbrojtjes lidhur me mungesën e motivit dhe konfliktit paraprak, reagimin e tij pas ngjarjes, dorëzimin vullnetar, dërgimin e viktimës në spital, qëndrimin e dëshmitarit okular, karakteristikat e armës, rezultatet e ekspertimit kimik dhe deklarimet për natyrën aksidentale të ngjarjes; iii) përfundimin mbi ekzistencën e dashjes indirekte, por është mjaftuar me konstatimin se mundësia e parashikimit të pasojës ka qenë e lartë, pa shpjeguar kalimin logjik nga ky konstatim te përfundimi se ai ka vepruar me dashje indirekte, ndërkohë që sipas nenit 15 të KP-së, nevojitet jo vetëm parashikimi konkret i pasojës, por edhe pranimi i vetëdijshëm i ardhjes së saj nga autori. Ajo gjykatë ka nxjerrë përfundime mbi anën subjektive të veprës kryesisht nga elementet objektive të saj, pa shpjeguar pse përjashtohet hipoteza e pakujdesisë. iv) individualizimin e dënimit, masën e dënimit dhe moszbatimin e rrethanave lehtësuese. Arsyetimi i asaj gjykate është kontradiktor, pasi nga njëra anë konstaton ekzistencën e mangësive serioze hetimore, ndërsa nga ana tjetër arrin në përfundimin

për fajësi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në arsyetim është përdorur terminologji juridike latine pa sqaruar kuptimin dhe zbatimin e saj në raport me nenin 15 të KP-së dhe rrethanat konkrete të çështjes, duke cenuar të drejtën e kërkuesit për të kuptuar arsyet e dënimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka çmuar rekursin të papranueshëm për shkak të afatit, por njëkohësisht ka dhënë një vlerësim sipërfaqësor se pretendimet nuk do të kishin sjellë rezultat tjetër, pa kryer një shqyrtim substancial të tyre.

20.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, në disa drejtime: i) kërkuesi nuk është informuar në kohë dhe në mënyrë adekuate për ndryshimet e akuzës, duke e privuar nga mundësia për të përshtatur strategjinë e mbrojtjes dhe për të paraqitur prova dhe argumente specifike, në kundërshtim me neni 375, paragrafi 2, të KPP-së; ii) kërkuesi është privuar padrejtësisht nga përfitimet e gjykimit të shkurtuar në kontekstin e ri procedural. Gjykata e apelit, duke refuzuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar me arsyetimin se kërkuesi nuk e kishte kërkuar atë formalisht në seancën paraprake të dytë (me akuzë të re), ka marrë një qëndrim tepër formalist dhe ka injoruar kontekstin e veçantë procedural që e kishte bërë praktikisht të pamundur rikërkimin e kësaj procedure; iii) mosruajtja e vendngjarjes dhe humbja e provave materiale e kanë vendosur mbrojtjen e kërkuesit në disavantazh substancial, duke e privuar nga mundësia për hetime të pavarura forensike dhe balistike mbi versionin e shkrepjes aksidentale, ndërsa akuza dispononte provat e mbledhura gjatë hetimit; iv) kërkuesi nuk ka pasur mundësi efektive të kundërshtojë interpretimin që gjykata e apelit u ka bërë pamjeve filmike të kamerave të sigurisë, pasi kjo gjykatë ka nxjerrë përfundime mbi qëllimin kriminal nga sjellje të regjistruara në video, të cilat janë spekulative dhe të pambështetura në prova; v) gjatë përsëritjes së pjesshme të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e apelit ka dëgjuar dëshmitarë dhe ekspertë sipas vlerësimit të saj, pa i dhënë mbrojtjes mundësi të plotë për të propozuar dëshmitarë shtesë ose për të paraqitur ekspertizë të pavarur balistike dhe teknike; vi) në seancën paraprake të datës 04.04.2018 gjyqtari ka ndërhyrë duke i kërkuar prokurorit ndryshimin e cilësimit juridik të akuzës, çka ka cenuar paanshmërinë procedurale dhe ka ndikuar negativisht në mundësinë e kërkuesit për të planifikuar dhe ushtruar në mënyrë efektive mbrojtjen.

20.3. *Së drejtës për gjykim të drejtë,* për shkak të disa shkeljeve procedurale serioze: i) kërkuesi është privuar në mënyrë të padrejtë nga përfitimi i gjykimit të shkurtuar,

pasi kërkesa e paraqitur në seancën paraprake të parë nuk është marrë parasysh pas ndryshimit të akuzës, ndërsa refuzimi i kërkesës së bashkëpandehurit për gjykim të shkurtuar për shkak të lidhjes së procedimeve, ka ndikuar negativisht në drejtësinë e procesit në tërësi; ii) gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar mbi bazën e fotokopjeve të njësuara të akteve, ndërkohë që fashikulli origjinal ndodhej në Gjykatën e Lartë, duke cenuar autenticitetin dhe verifikueshmërinë e provave. Administrimi i mëvonshëm i akteve origjinale nuk e korrigjon këtë mangësi procedurale; iii) mosruajtja e menjëhershme e vendngjarjes dhe vonesat në dokumentimin e saj kanë kompromentuar mbledhjen e provave materiale dhe kanë kufizuar mundësinë e mbrojtjes për të kryer verifikime të pavarura; iv) ndryshimet e përsëritura të cilësimit juridik të veprës penale kanë krijuar pasiguri juridike dhe kanë cenuar aftësinë e kërkuesit për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive akuzës, ndërsa gjykata e apelit nuk ka dokumentuar mjaftueshëm se palëve u është dhënë njoftim dhe mundësi reale mbrojtjeje përballë cilësimit më të rëndë; v) gjykata e apelit ka arritur në përfundime faktike të ndryshme nga ato të gjykatës së shkallës së parë, kryesisht përmes rivlerësimit të provave ekzistuese, pa kryer hetime shtesë domethënëse dhe pa dhënë arsye të mjaftueshme për këtë devijim; vi) gjykata e apelit ka mbajtur një qëndrim kontradiktor, pasi nga njëra anë ka konstatuar mangësi serioze në hetim dhe mosndjekje të veprave të tjera penale, ndërsa nga ana tjetër ka rënduar pozitën penale të kërkuesit duke ndryshuar vendimin e shkallës së parë, në kundërshtim me standardet e procesit të rregullt ligjor dhe të provueshmërisë së fajësisë.

20.4. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykata e apelit ka transferuar barrën e provës mbi kërkuesin, duke mbështetur përfundimin mbi ekzistencën e dashjes indirekte në rrethana neutrale ose të paqarta, si dalja dhe rikthimi i tij në lokal apo mbajtja e armës pa leje, duke pritur që ai të jepte shpjegime për këto rrethana. Provat e administruara nuk e provojnë elementin subjektiv të veprës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, pasi ekzistojnë versione alternative të arsyeshme të ngjarjes që përputhen me provat objektive dhe mbështesin tezën e shkrepjes aksidentale. Në këtë kuadër, gjykata e apelit nuk ka zbatuar parimin *in dubio pro reo*, megjithëse kanë ekzistuar elemente të rëndësishme dyshimi lidhur me dashjen, të mbështetura nga deklarimet e tij dhe të dëshmitarëve, karakteristikat e armës, rrethanat teknike të plagosjes dhe mungesa e një motivi të arsyeshëm. Gjykata e apelit ka nxjerrë përfundime mbi

dashjen kryesisht nga indicie, si mbajtja e armës pa leje, lëvizjet e tij para ngjarjes, afërsia me viktimën dhe vendndodhja e plagës, ndonëse këto rrethana nuk provojnë domosdoshmërisht qëllimin kriminal dhe nuk plotësojnë kushtet ligjore për nxjerrjen e përfundimeve të sigurta mbi fajësinë. Ajo gjykatë ka arritur në përfundim të kundërt me gjykatën e shkallës së parë mbi bazën e rivlerësimit të të njëjtave prova, pa evidentuar gabime konkrete në analizën e kësaj të fundit, si dhe ka bërë një vlerësim selektiv të provave, duke favorizuar ato që mbështesnin akuzën, duke mos trajtuar në mënyrë të mjaftueshme provat në favor të tij. Disa sjellje neutrale të kërkuesit si dalja nga makina dhe kthimit sërish me çantë, janë interpretuar në mënyrë spekulative nga gjykata e apelit si tregues i qëllimit kriminal, duke nënkuptuar se ai e kishte planifikuar dhe përgatitur veprën.

20.5. *Parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit (reformatio in peius),* pasi duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale gjykata e apelit ka rritur dënimin e kërkuesit nga 7 në 16 vjet burgim, ndërkohë që prokurori i çështjes kishte kërkuar në seancë gjyqësore prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, dhe jo ndryshimin e vendimit me dënim më të rëndë. Pra, gjykata ka shkuar përtej kërkimit të prokurorit dhe ka dhënë një vendim ndëshkues edhe më të rëndë sesa çfarë u kërkua nga akuza.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

22. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji vlerëson plotësimin e një ose më shumë kritereve të pranueshmërisë, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare (*shih vendimin nr. 161, datë 21.05.2026 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

23. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kritereve të pranueshmërisë lidhur me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion dhe atë të *ratione materiae*. Për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës kërkojnë që individi t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Referuar vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ajo gjykatë ka konstatuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është depozituar jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 435 i KPP-së, duke arsyetuar se kjo rrethanë përbën pengesë formale për marrjen e tij në shqyrtim, pasi respektimi i afatit të rekursit është kusht i domosdoshëm procedural, mospërmbushja e të cilit sjell si pasojë mospranimin e mjetit të ankimit, pa u kaluar në vlerësimin e tij në themel. Kërkuesi, nga ana e tij, nuk ka parashtruar ndonjë pretendim të qenësishëm në këtë drejtim, konform detyrimit që ka për shkak të natyrës argumentuese që ka paraqitja e kërkesës për nisjen e gjykimit kushtetues. Kërkuesi nuk jep argumente se përse konstatimi i Gjykatës së Lartë është i gabuar nga pikëpamja faktike. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, për shkak të paraqitjes së rekursit jashtë afatit dhe mosparaqitjes së argumenteve kundër këtij konstatimi të Gjykatës së Lartë në ankimin e tij kushtetues individual.

25. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se pavarësisht këtij konstatimi të Gjykatës së Lartë, ajo ka çmuar se është e nevojshme të shprehet shkurtimisht edhe mbi thelbin e pretendimeve të ngritura në rekurs, me qëllim që vendimmarrja të jetë e plotë dhe e arsyetuar në përputhje me funksionin e asaj gjykate. Megjithatë, ajo ka theksuar kjo qasje nuk ndryshon përfundimin se rekursi nuk përmbush kushtet formale të pranueshmërisë, por shërben për të konfirmuar se, edhe sikur të ishte depozituar brenda afatit, pretendimet e kërkuesit nuk do të kishin mundur të çonin në një vendimmarrje të ndryshme (*shih paragrafët 57 dhe 58 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për këtë arsye, Kolegji çmon të ndalet edhe në analizën e kriterit të legjitimimit *ratione materiae*. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se pretendimet që kërkuesi i ka ngritur të paktën në substancë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ose ato që i ka lidhur me vendimin e kësaj të fundit, për kundërshtimin e të cilave nuk ka më mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual, lidhen me mohimin e së drejtës për gjykim të shkurtuar, me parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale në ngarkim të tij.

26. Për sa i takon pretendimit për mohimin e së drejtës për gjykim të shkurtuar, i cili lidhet me *parimin e mosdënimit pa ligj,* Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjyqtari i seancës paraprake që i ka kërkuar prokurorisë të ndryshojë akuzën, e ka vënë atë në pamundësi për të kërkuar sërish gjykimin e shkurtuar. Edhe gjykata e apelit, sipas tij, duke refuzuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar, me arsyetimin se kërkuesi nuk e kishte kërkuar atë formalisht në seancën paraprake të dytë, ka marrë një qëndrim tepër formalist dhe ka injoruar kontekstin e veçantë procedural që e kishte bërë praktikisht të pamundur kërkimin përsëri të kësaj procedure, duke cenuar të drejtën për të përfituar nga mjetet procedurale lehtësuese të parashikuara nga ligji.

27. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, për sa i takon ritit procedural të gjykimit të shkurtuar, Gjykata ka pohuar se ai (gjykimi i shkurtuar) nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit *(shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ndërsa në lidhje me karakteristikat e gjykimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur i pandehuri ka bërë

kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar debatit gjyqësor provat dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime për këtë vlerësim, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

28. Në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, Kolegji vëren se në seancën e parë paraprake kërkuesi ka bërë kërkesë për gjykim të shkurtuar, ndërsa gjykata i ka kërkuar prokurorisë ndryshimin e akuzës në ngarkim të tij. Në seancën paraprake të dytë, ku prokuroria ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq duke e akuzuar kërkuesin për kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje, ky i fundit nuk e ka paraqitur sërish kërkesën për gjykim të shkurtuar, por ka kërkuar që gjykimi të vijonte me procedurë të zakonshme të gjykimit, duke i qëndruar akuzës së vrasjes nga pakujdesia *(shih paragrafin 54.19. të vendimit të Gjykatës së Lartë).* Gjykata e rrethit gjyqësor, nga ana tjetër, nuk ka pranuar as kërkesën e të pandehurit tjetër për gjykim të shkurtuar, pasi çështja, sipas asaj gjykate, nuk mund të veçohej, ndaj duhej që gjykimi të vazhdonte me procedurën e zakonshme. Në këtë kuptim, ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar. Në çdo rast, Kolegji evidenton se gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili mund të refuzojë kërkesën nëse mendon se është i nevojshëm një proces i mirëfilltë penal, pasi është në çmimin e gjykatave të faktit nëse çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet dhe në rastin konkret kërkuesi kishte pretendime për cilësimin juridik të veprës në ngarkim të tij, të cilat janë gjetur të pabazuara nga gjykata e apelit, pas marrjes së provave në seancë gjyqësore.

29. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt* në drejtim të *parimit të prezumimit të pafajësisë dhe së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të standardit kushtetues të të provuarit të fajësisë për veprën penale, për të cilën kërkuesi është dënuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, sipas nenit 30 të Kushtetutës, si dhe mënyrën e arsyetimit të gjykatave të zakonshme lidhur me cilësimin juridik të veprës më të rëndë në ngarkim të kërkuesit, sipas nenit 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë do t'i analizojë pretendimet e tij në këtë drejtim.

30. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t’i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kurse për sa i përket standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, në kuptim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Bazuar në vendimet gjyqësore që kanë shqyrtuar çështjen e kërkuesit, Kolegji vëren se ai është proceduar penalisht për ngjarjen e datës 22.09.2017, në të cilën ka gjetur vdekjen një person. Kërkuesi ka mbajtur përgjegjësi për ngjarjen duke u dorëzuar në polici, por ka pretenduar se e ka kryer vrasjen nga pakujdesia. Gjatë hetimeve paraprake janë kryer një sërë veprimesh hetimore (*shih paragrafët 2 dhe 3 të vendimit*) dhe çështja është dërguar për gjykim fillimisht me akuzën e vrasjes nga pakujdesia dhe pas vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake është ndryshuar kualifikimi në vrasje me dashje. Gjykata e shkallës së parë e ka gjetur fajtor kërkuesin për kryerjen e veprave të vrasjes nga pakujdesia dhe mbajtja pa leje e armëve. Sipas saj, nuk rezulton që vrasja e viktimës të ketë ardhur si rezultat i veprimeve të kryera në rrethana të veçanta, në gjakftohtësi, në zënkë, rrahje ose grindje midis autorit dhe viktimës, por nga deklarimet e personit të pranishëm në ngjarje është provuar se ata kanë qenë shokë dhe se natën e ngjarjes viktima e ka ftuar të pandehurin për të pirë diçka dhe se menjëherë sa është shkrepur arma ai është ngritur në këmbë duke bërtitur "Çfarë bëra" dhe së bashku me shtetasin V.T. e kanë dërguar në spital.

33. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, e cila ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës në ngarkim të kërkuesit, duke rritur rrjedhimisht dhe dënimin për të. Sipas saj, në ndryshim nga forma e pakujdesisë e interpretuar në mënyrë të gabuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila e sheh pasojën thjesht të "mundshme", duke keqinterpretuar riskun e ardhjes së pasojave të paligjshme për shkak të mungesës së kujdesit të duhur për ta evituar atë, në dashjen indirekte, sipas gjykatës së apelit, pasojat provohen që parashikohen "pothuajse të mundshme". Që nga momenti që i pandehuri ka shkuar dhe ka marrë pistoletën, ka krijuar premisat e një ngjarjeje, e cila mund të ndodhte dhe rrethanat treguan se ajo ndodhi dhe ai lejoi verifikimin e tyre, veprime këto që, sipas gjykatës së apelit, tregojnë për vendosmërinë e kërkuesit në arritjen e qëllimit kriminal, vrasjen e viktimës. Gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje dhe pretendimeve të mbrojtjes lidhur me gjykimin me fotokopje të akteve dhe atë lidhur me gjykimin e shkurtuar. Ajo gjykatë ka evidentuar se vendi i ngjarjes nuk është siguruar menjëherë, por pas një dite dhe se nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore për t'u siguruar që nga ngjarja e ndodhur në vend publik nuk janë dëmtuar persona të tjerë. Për rrjedhojë, ajo ka konstatuar se hetimet ishin të paplota në këto drejtime, duke sugjeruar marrjen nën përgjegjësi penale të oficerëve të Policisë Gjyqësore (*shih paragrafët 12-15 të vendimit*). Ndërsa Gjykata e Lartë, ndonëse ka konstatuar se rekursi është paraqitur tej afatit ligjor, ka marrë në shqyrtim tre pretendimet kryesore të kërkuesit, të cilat i ka gjetur haptazi të pabazuara (*shih paragrafët 16-19 të vendimit*).

34. Në referim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj kërkuesit, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit nuk rezulton që të ketë

arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e kërkuesit lidhur me veprën për të cilën e ka dënuar. Ajo gjykatë e ka mbështetur vendimin për fajësinë e tij mbi analizën tërësore të provave të administruara në gjykim, të pasqyruara edhe në vendim, të cilat i ka shqyrtuar e vlerësuar në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën, duke parashtruar në vendim edhe shkaqet mbi të cilat ajo ka arritur në përfundimin e shprehur në dispozitiv dhe që kanë përbërë shkak për ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka analizuar dhe arsyetuar në vendimin e saj sesi ana objektive e figurës së veprës penale ka reflektuar anën subjektive, konkretisht dashjen indirekte në ardhjen e pasojave, duke e lidhur veçanërisht me marrjen e armës në takim nga kërkuesi, afërsinë dhe drejtimin e goditjes. Ajo gjykatë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit si lidhur me gjykimin e shkurtuar dhe gjykimin me aktet në formën e fotokopjes (*shih paragrafët 14 dhe 15 të vendimit)*. Arsyetimi i saj nuk duket kontradiktor, pasi ndonëse ka konstatuar mangësi në hetime, ajo i ka përcaktuar drejtimet në cilat janë konstatuar këto mangësi, pra jo në drejtim të provueshmërisë së kryerjes së veprës penale nga kërkuesi (*shih paragrafin 13 të vendimit*). Gjykata e apelit nuk duket të këtë ndërtuar prezumime faktike të paarsyeshme dhe as të ketë zhvendosur barrën e provës nga akuza tek i pandehuri. Arsyetimi i saj është marrë në shqyrtim edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili, në ushtrim të kompetencave të tij, e ka gjetur të drejtë dhe të bazuar atë vendim, duke i konsideruar të pabazuara shkaqet e parashtruara në rekurs.

35. Kolegji vëren gjithashtu se në rekurs, sikundër në ankimin kushtetues individual, kërkuesi nuk ka pasur kundërshtime konkrete për mënyrën e marrjes së provave, por pretendimet e tij kanë të bëjnë me mënyrën sesi janë vlerësuar këto prova nga gjykata e apelit dhe më pas nga Gjykata e Lartë në arritjen e përfundimit për fajësinë e tij për veprën penale, për të cilën është akuzuar. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme, ashtu edhe ato për vlerësimin e ligjit penal material të zbatueshëm nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues për sa kohë që, bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, nuk rezulton që ato të jenë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra që të vënë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për një gjykim të drejtë. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

36. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, kërkuesi nuk ka *shteruar mjetet juridike efektive* në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës. Po kështu, ai nuk legjitimohet as *ratione materiae*.

37. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat "d" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.